



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1569/14 Prot.

Tiranë, më 20.06.2023

V E N D I M

Nr. 45 datë 20.06.2023


**“MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR FITUESIT E PROJEKTEVE  
KËRKIMORE SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË  
TIRANËS”**

Në mbështetje dhe në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH” neni 3, të Vendimit të Rektoratit nr.57 datës 08.06.2023, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 67 datë 13.06.2023 “Miratimin e kontratës tip për fituesit e Projekteve Kërkimore Shkencore në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 20.06.2023

V E N D O S I :

1. Të miratojë kontratën tip e cila lidhet midis fituesit të Projekte Kërkimore Shkencore dhe UST (bashkëlidhur kontrata tip).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Komisioni i Projekteve Kërkimore Shkencore në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek trasparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ 2023

**KONTRATË**

**PËR PROJEKTE KËRKIMORE SHKENCORE**

" \_\_\_\_\_ "

Sot, më datë \_\_\_\_\_ 2023 në Tiranë, ndërmjet:

Drejtuesit të Njesisë Kryesore \_\_\_\_\_; Drejtuesit të Njesisë Bazë \_\_\_\_\_, Kryetarit të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore, \_\_\_\_\_ Anetarit të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore të Ngarkuar me Vlerësimin Ekonomik të Projektit, Administratorit të UST- së, Znj. \_\_\_\_\_ dhe Drejtuesit të Grupit Kërkimor të këtij projektit \_\_\_\_\_:

lidhet kontrata me kushtet që vijojnë:

1. Kjo kontratë mbështetet në Vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ të Senatit Akademik të UST-së; Vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ të Bordit të Administrimit, si dhe Vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore.

2. Dokumenti i Projektit për Kërkim dhe Zhvillim me titull:

\_\_\_\_\_ me drejtues projektit \_\_\_\_\_ i cili është paraqitur për financim në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore të UST-së, në kuadër të fondit të alokuar për kërkim shkencor nga ana e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

3. Ky projekt pasi ka kaluar vlerësimin akademiko-shkencore në njësinë bazë, njësinë kryesore dhe në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore të Senatit Akademik të UST-së, si dhe ka marre vlerësimin ekonomik sipas preventivit të miratuar nga ana e anëtarit të posaçëm të këtij komisioni i cili është përgjegjës për vlerësimin dhe ndjekjen e realizimit nga ana financiare të çdo faze të projektit të miratuar për zbatim.

3. Financimi i projektit sipas vlerësimit dhe miratimit do të fillojë më datë \_\_\_\_\_ 2023 dhe do të perfundojë në datën \_\_\_\_\_ 2023.

4. Likujdimi i situacioneve të paraqitura nga Drejtuesi i Projektit , likujdohen vetëm pasi kanë marrë miratimin dhe firmën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore , Drejtuesit të Njesisë Bazë, Kryetarit të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore, Anëtarit të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore të Ngarkuar për Vleresimin Ekonomik të Projektit.

Për vitin 2023 projekti do të financohet me \_\_\_\_\_ Lekë.

Për projekte që zgjasin më shumë se një vit, fondi për vitin pasardhës jepet vetëm pas miratimit nga ana e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të alokimit të fondeve për kërkimin shkencor dhe vetëm në ato raste kur, nga ana e Drejtuesit të Projektit është paraqitur një raport i detajuar për realizimin e detyrave të vitit paraardhës, i miratuar nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore, Drejtuesit të Njesisë Bazë, Kryetarit të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore, Anëtarit të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore të Ngarkuar për Vleresimin Ekonomik të Projektit, SA dhe BA dhe më pas lidhet kontrata për financim vjetor .

Aparaturat, pajisjet dhe baza tjetër materiale e nevojshme për kryerjen e studimit, sigurohet nga pala zbatuese duke ndjekur të gjithë kuadrin ligjor financiar në fuqi.

5. Pala zbatuese, në fund të çdo faze të projektit, raporton në Njësinë Bazë, Njësinë Kryesore dhe në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore ku merr çertifikimin dhe miratimin e realizimit të objektivave të fazës së përfunduar. Ky raport i hartuar nga Drejtuesi i Projektit pasi ka marrë miratimin dhe firmën e drejtuesit të njësisë bazë dhe kryesore i kalon për miratim e firmë Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore. Komisioni me marrjen e këtijë raporti mund të thërrasë për sqarime të mëtejshme Drejtuesin e Grupit Kërkimor. Për projektet që shtrihen në më shumë se një vit, rezultatet vjetore të projektit të cilat kanë kaluar procedurën e përshkruar më lart dërgohen për miratim të mëtejshëm në njësinë bazë, njësinë kryesore dhe në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore për të marrë miratimin e vazhdimin të projektit së bashku me planin e detajuar të punës për fazat në vijim.

6. Një kopje e studimit dhe e opionecave, pas shqyrtimit dhe miratimit në Njësinë Bazë , Njësinë Kryesore, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore duhet të marrin një vlerësim përfundimtar nga një grup ekspertëshi i cili krijohet me vendim të Senatit Akademik jo më vonë se dy muaj nga data e paraqitjes së materialit përfundimtar të miratuar. Së bashku me studimin dorëzohet dhe situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas zërave i miratuar sipas përshkrimit në pikën 4 të kësaj kontrate .

7. Përdorimi i rezultateve dhe i informacionit të studimit nga zbatuesit do të jetë vetëm me autorizim të organit që financon projektin.

8. Kur afati i kryerjes së studimit nuk respektohet në kohë për shkaqe të pa përligjura dhe pa miratim paraprak sipas pikave të kësajë kontrate, Drejtuesi i Grupit Kërkimor i cili ka përfituar grantin , detyrohet të kthejë financimin .

Kjo kontrata u përpilua në gjashtë kopje me vlerë të barabartë ku secila palë (Njësia Kryesore, Njësia Bazë, Drejtuesi i Grupit Kërkimor, Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore, Anëtari i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore i Ngarkuar për Vlerësimin Ekonomik të Projektit dhe Adminstratori ) mbajne nga një kopje.

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

**Drejtuesi i Njesisë Bazë**

**Drejtuesi i Njesisë Kryesore**

**Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore, Anëtari i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë**

**Anetari i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore i Ngarkuar me Vlerësimin Ekonomik të Projektit**

**ADMINISTRATORI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Aneks II

**KONTRATË**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më / /2023

**PER FINANCIM VJETOR  
Viti 2023**

Sot, më datë / /2023, në Tiranë, ndërmjet:

Universiteti i Sporteve të Tiranës financues, institucion financues përfaqësuar nga Rektori i UST-së, \_\_\_\_\_; Administratori i UST-së, \_\_\_\_\_. Drejtuesit të Njesisë Kryesore \_\_\_\_\_, Drejtuesit të Njesisë Bazë, \_\_\_\_\_ dhe Grupi Kërkimor Shkencor i Projektit përfaqësuar nga Drejtuesi i Grupit Kërkimor Shkencor \_\_\_\_\_, në vijim të Kontratës së Përgjithshme ndërmjet palëve, lidhur më \_\_\_\_\_ 2023 për financimin e projektit me titull:

\_\_\_\_\_ në kuadër të Strategjisë për Kërkimin Shkencor të Universitetit të Sporteve të Tiranës, lidhet kontrata me kushtet që vijojnë:

Për vitin 2023 projekti do të financohet me \_\_\_\_\_ Lekë.

Pikat e tjera të Kontratës së Përgjithshme nuk ndryshojnë.

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Drejtuesi i Njesisë Bazë

\_\_\_\_\_  
Drejtuesi i Njesisë Kryesore

\_\_\_\_\_  
REKTORI

ADMINISTRATORI

\*Palët, kur ka arsye të arsyetuara dhe në mirëkuptim, mund të ndryshojnë pika te Kontratës së Përgjithshme, t'i heqin, t'i shtojnë ose t'i ndryshojnë ato, duke i specifikuar të gjitha këto ndryshime në Kontraten Vjetore të radhës.

## **SKEMA E RAPORTIT VJETOR**

### **Për realizimin e detyrave dhe financimit për vitin në vazhdim dhe Projektplanin e punës dhe financimit për vitin pasardhës**

Raporti vjetor bëhet për çdo projekt më vete dhe i paraqitet organit financues në dyjavorin e parë të muajit Dhjetor të vitit në vazhdim. Ai përmban:

**I.** Raportin për realizimin e detyrave të parashikuara në planin e punës dhe financimit (Aneks IV/1).

**II.** Pasqyrën e realizimit të financimit sipas artikujve (Aneks IV/2).

**III.** Projektplanin e detajuar të punës për vitin pasardhës (Aneks IV/3) IV. Projektplanin e financimit të projektit për vitin pasardhës (Aneks IV/4).

**V.** Listën e plotë të pajisjeve që kërkohet të blihen dhe të shpenzimeve të tjera kapitale për vitin \_\_\_\_\_ (pasardhës) (Aneks IV/5).